

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtore Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë te ndryshëm si dhe media.

Pika e 1-rë e rendit të ditës – Miratimi i rendit të ditës.

Elvi Çuni – Sekretar i Këshillit Bashkiak

Bën apelin e këshilltarëve. Marrin pjesë anëtarë te këshillit bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pershendetje te gjithëve.Mirëseerdhët në këtë mbledhje te datës 5 tetor.Sipas apelit te bërë nga sekretari janë 42 anëtarë te këshillit b ashkiak.Kuorumi eshtë vazhdojmë mbledhjen, Kalojmë me miratimin e rendit te ditësKush eshtë dakord?

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak.

Tek rendi i ditës ka një material këtu në fund që nuk eshtë konsultuar në komision, eshtë pika për dhëniën e fondit pyjor.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Eshtë pika tek te ndryshmet.

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak.

Jo nuk eshtë tëk te ndryshmet.Ky material ka të bëjë me pronat, dhe pronat nuk janë tek te ndryshmet.Për mendimin tim nuk mund te futet dhe mendoj te mos miratohet.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë

Materiali në raport që po i referohet këshilltari, në fakt ka të bëjë me pikën 1 tek te ndryshmet e rendit te ditës dhe nuk eshtë një material i ri Sokol, dhe ti si këshilltar i vjetër besoj e ke te qartë se për kë material bëhet fjalë.Ky eshtë një material i miratuar që ka kaluar te gjitha hallkat e vendimmarrjeve përkatëse qoftë te këshillit apo lejeve në Ministri, dhe ka një raportim minimal në disa sipërfaqe që kalojnë 2 apo 3 m² apo 20 m linear në total që vjen për shkak te raportimit në total

të lejeve të Ministrisë dhe pasaktësisë së hartave, dhe nuk ka një vendimmarje në thelb që ka të bëjë me dhënien në përdorim. Ky material është paraqitur përparrë komisioneve që po zhviloheshin dhe unë Z. Kryetar kërkoj që ju t'i térhiqni vëmëndjen këshilltarëve për pjesëmarrjen në komisione për një mbarëvajtje më normale të punës nga këto komisione. Këtë herë komisionet kanë qënë pothuajse me një pjesëmarrje minimale nga të gjitha palët, dhe pjesëmarrja në komision është një detyrim ligjor dhe ashtu si kundër kërkojmë që të respektohet rregullorja në cdo pikë. Kështu që është shqyrtuar edhe nga ata që kanë qënë nga komisioni i mjedisit dhe nuk kanë asnjë pengesë ligjore në raport me futjen. Nëse ju keni ndonjë argument ligjor që ky material nuk duhet të jetë, atëherë e diskutojmë.

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak.

Materiali nuk është sjellë në komision.

Erian Murataj – antar i këshillit bashkiak

E para në miratimin e rendit të ditës duhet t'i referohemi proces verbalit të mbledhjes së kaluar ku këshilli votoi për diskutimin në mbledhjen e rradhës për cështjen e fondit pyjor në Shelcan. Unë nuk e shikoj në rendin e ditës sot, dhe për sa kohë nuk e shikoj në rendin e ditës nuk kemi si vijojmë me pikën 2 që është dhe miratimi i proces verbaleve. Kaq për dy pikat e para.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Kolegë, përsa i përket rendit të ditës, ai u hartua në bashkëpunim me 2 n/kryetarët e këshillit, por pjesëmarrja në komisione është shqetësuese dhe kemi përgjegjësi dhe ne si antarë të këtij këshilli.

Proces verbali për mbledhjen e parë mbaxe nuk është zbardhur komplet ose nuk e di se cfarë problemi pati. Është cuar më e-mail. Dhe përderi sa nuk është përgatitur material do të thotë që nuk është pjesë e rendit të ditës. Edhe kjo që ngre Sokoli nuk është ky material, pra deri sa nuk është përgatitur materili kjo pikë është nul.

Xhuliana Abazi – specialiste (për protokollin) e këshillit bashkiak.

Proces verbalet e të dy mbledhjeve si ai i dt. 31.08.2023 dhe ai i dt. 13.09.2023 i është dërguar këshilltarëve me e-mail që ta lexojnë e të shprehin nëse kanë vërejtje apo jo. (Këshilltarët shprehen që e kanë marrë të gjithë me e-mail.)

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak.

Përshëndetje të gjithëve. Për procedurë, ajo që doja të shtoja ka të bëjë me dy momente që do të kërkoj që të trajtohesin e të bëheshin pjesë e rendit të ditës.

Së pari nga ana juaj i nderuar kryetar i këshillit bashkiak, është bërë një konsultim publik në Labinot Fushë.Për gjithë pjesëmarrësit dhe këshilltarët pér të trëguar ecurinë pikërisht të konsultimit publik.Së pari u bë një konsultim publik i cili u refuzua sepse nuk kishte asnjë projekt, ishte pa firma dhe i pa detajuar. E-maili sot ishte shumë i shkurtër. Dua të shtoj

E para – Një konsultim publik duhet të ketë publik të gjërë

E dyta – Konsultimet me publikun nuk bëhen fshehtas - Por mendoj që kjo pikë duhet futut.Na e dëgjoni fjalën se ne këtë kemi. Ligji 146/2014 pretendon...

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E vazhdojmë tek rendi i ditës.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak.

Pse nuk ma le ta mbaroj fjalën. Ky material nuk mund të hyjë tek pika të ndryshme, pasi nuk është bërë asgjë publike, kush është vlera, kush është impakti, kush është kompania fituese etj.Gjëja tjetër që kam është se në fshatin Bujqës ka një konflikt pér bllokim kanali. Këshilli bashkiak ka marrë një vendim pér këtë problem. Ka 10 familje qe i është bllokuar kanali, dhe është një banor i cili është Arif Tafani që ka bllokuar këtë kanali. Ka proces verbale pér këtë problem ku i është kërkuar këshillit bashkiak hapja e këtij kanali.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pika parë është bërë konsultim me publikun

Altin Mecja – antar i këshillit bashkiak.

Katër vetë kanë qënë atë ditë në orën 9 të mengjesit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak

Është ë drejtë pér kanalin në fshatin Bujqës ekziston konflikti.Unë i propozoj drejtorisë përkatëse të Bashkisë të na sjellë një relacion pér këtë problem.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak.

Pér një person që është i partisë tuaj, ju bllokoni 10 familje. Ju si Bashki e administroni kanalin dhe po nuk qetë në dijeni, mos na jepni përgjigje të pa sakta.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak


Tek pika të ndryshme do shtohet pika e konsutimit.

E hedh në votim rendin e ditës.

Këshilli bashkiak m e 24 vota pro, kundër, abstenim nuk ka miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë te ndryshëm si dhe media.

Pika e 2-të e rendit të ditës – Miratimi i procesverbalit të mbjedhjes së muajit Gusht (dt.31.08.2023 dhe muajit shtator (13.09.2023).

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim pikën e dytë të rendit të ditës.

Këshilli bashkiak m e 23 vota pro, kundër, abstenim nuk ka miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 3 dhe 3/1 e rendit të ditës

Pika 3-të e rendit të ditës – Dhënia e Ndihmës Ekonomike nga fondi Bashkisë përmuanjin Gusht 2023.

Pika 3-të e rendit të ditës – Dhënia e Ndihmës Ekonomike nga fondi kushtëzuar përmuanjin Gusht 2023.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Në mbledhjen e 31 gushtit është kërkuar një informacion për kriteret e ndihmës ekonomike, i cili bën të mundur që ne të miratojmë materialet e ndihmës ekonomike.Të mos dalim në situata të tilla që jepet fondi për të verbërit, dhe i kalon ndihmës ekonomike.Përcaktimi nominatit të kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike të qartësohet që këto familje kanë vërtet nevojë për t'u trajtuar.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Është i drejtë ky problem që ngrini ju.

Erian Murataj – antar i këshillit bashkiak

Jam i gjëzuar që përgjegjësitë pranohen dhe i lumtur që korigjohen. Por përgjegjësi është ku një turmë prej 80 vetësh votojnë për kryeplakun e Katundit të Ri dhe Bradashesh. Unë nuk jam dakord me këtë dhe do të bëj ankesë me shkrim.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Është e drejtë kjo gjë që trajtoni ju por ka qënë një gabim.

I hedh në votim 2 materialet e ndihmës ekonomike.


Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, 1 kundër, 2 abstenim miratohet sa më sipër.

Votoi kundër – Doris Madhi

Abstenuan – Rudina Mita, Ergys Muzhaqi.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi




Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 4-tërt, 5-të dhe e 6-të rendit të ditës

Pika e 4-tërt, rendit të ditës- Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ardjan Kotorri, banor në lagjen Emin Matraxhiu, nr. 1 dhe dhënien e shpërbimit finanziar nga ana e Bashkisë Elbasan.

Pika e 5-të rendit të ditës- Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Fatime Selimi, banore në lagjen Emin Matraxhiu, nr. 1 dhe dhënien e shpërbimit finanziar nga ana e Bashkisë Elbasan.

Pika e 6-të rendit të ditës- Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Petrit Cikoja, banor në fshatin Griqan, Njësia Administrative Labinot Fushë dhe dhënien e shpërbimit finanziar nga ana e Bashkisë Elbasan.

Shefjet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Këto materiale u shqyrtuan në komision. Janë materiale që kanë të bëjnë me vlera të vogla dhe komisioni është dakord pasi është ndihmë që plotëson pjesërisht nevojat e këtyre familjeve.


Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

I hedh në votim 3 materialet e pikës 4,pikës 5, dhe pikës 6.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kundër, abstenim nuk ka miratohet sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elyi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 7-të e rendit të dites - Raportimi i monitorimit të buxhetit të katër mujorit të dytë të vitit 2023.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Raporti monitorimit u diskutua në komision duke bërë dhe krahasimin me 8 mujorin e vitit 2022 dhe shihet që ka një rritje, por pritet edhe 4/mujori i III-të që të shihet gjendja në total. Komisioni është dakord por me 2-3 sugjerime të vogla.Presim të mbyllt dhe tremujori katërt që të ngushtohet diferenca e realizimit të të ardhurave.

Artan Kana – antar i këshillit bashkiak.

Në këtë pikë kisha dicka për të shtuar, dicka që vihet re dhe me sy të lirë që ka një rënje të theksuar të të mbledhurave të të ardhurave nga plani që keni pasur, dhe është në vlerën 52 % të realizimit.Dhe disa pika që unë i shoh problematike janë të ardhurat nga legalizimet që është një rënië shumë e madhe, dhe kjo përkon dhe me periudhën zgjedhore, c'ka do të thotë që kuptohet sepse kanë rënë. Një e ardhur tjetër që na mburret qeveria është taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier, e cila ka një rënië drastike për mos me thënë që është zero fare.Nje qytet si Elbasani që është cilsuar dikur si qyteti i qyteteve, të ketë të ardhura kaq të vogla nga shërbimi hotelier, që presupozohet nga turizmi që nenkupton që turizmin ne e kemi zero.Ky është një dështim total i këtij plani për të realizuar të ardhura, sidomos në këtë pikë më kryesore që gjithë Shqipëria po mburret që është turizmi, ku ne edhe në këtë rast jemi qyteti i fundit, sic jemi edhe në fushën e ndotjes së mjedisit, në fushën e arsimit, në këtë rast edhe të turizmit.Prandaj po e shtoj që në pikën 8 që

është pasardhësja e këtij materiali të ketë një vëmëndje të shtuar e Bashkisë ndaj këtij sektori të turizmit.

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak

E kam parë me mjaft vëmëndje raportin e monitorimit të Bashkisë, dhe nuk kuptoj pjesën...

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

A mund të sqaroj në lidhje me konstatimin e parë dhe pastaj vazhdojmë.

Në raport me realizimet, e para nuk përdoret termat “rënie”, sepse rënie quhet krahasimi 8 mujor me 8 mujor, dhe në këtë krahasim jemi në një realizim më të lartë, dhe jemi akoma duke realizuar të ardhurat. Kemi dhe \$/mujorin e III-të të realizimit të buxhetit.Zërat që ndikojnë në këtë përqindje realizimi në fakt i dedikohen zërave komplet, të ndryshëm nga ata të cilët i sollët në vëmëndje.Në raport me të ardhurat nga legalizimet, keni të drejtë, ka një rënie, ky është një shqetësim dhe i administratës së bashkisë, është një shqetësim i përbashkët, por kjo nuk lidhet fare me periudhën zgjedhore, sepse nëse do ishte kjo që ju i referoheni do ishte krejt e kundërta.Kjo lidhet me një VKM që daton dy vjet përpara, e cila heq detyrimin e pajisjes me leje legalizimi vetëm pasi është paguar taksa e infrastrukturës nga ndërtimet informale në institucionin e bashkisë.Dhe për këtë arsyе sot është një tarifë krejt e lirë që duhen krijuar mekanizma të tjerë që janë shumë të vështira në raport me qytetarin për ta mbledhur. Për këtë arsyë ka një rënie dhe është një shqetësim i përbashkët, por mekanizmat detyrues që parashikonte ligji 2 vjet përpara, janë të ndryshuara, kështu që ne jemi duke u përpjekur që këtë ta realizojmë me anë të mekanizmave vendorë.Ndërkohë që në raport me pjesën e fjetjes, taksën hoteliere, desha të them që në ndryshim nga ajo që ju thoni, është shumë e dukshme, që treguesit tregojnë që turizmi është rritur ndjeshëm edhe në qytetin e Elbasanit ashtu sikundër në të gjithë Shqipërinë. Vetëm se ka tipologji turizmi të ndryshme, dhe nuk është turizëm detar që të ardhurat të jenë në këtë periudhë, por pikërisht në këtë periudhë që ne po flasim, të ardhurat nga hoteleria janë ato që vijnë nga turizmi kurativ dhe ju tanë do shikon që ky tregues, është periudha tanë që fillon i rrit sepse, hoteleria që zë pjesën më të madhe le të themi, jo që mungon pjesa tjetër e hotelerisë, por hoteleria që sjell pjesën më të madhe të të ardhurave është hoteleria e turizmit kurativ.Për këtë arsyë 4/mujori i fundit do jetë ai që do tregojë raportin e rritjes së të ardhurave.

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak

Atëherë Z. Kryetar do thoja që e kam parë me goxha kujdes raportin, dhe ashtu sic thoni juve që ka disa pjesë ku ka rritje, kjo është evidente. Megjithate unë edhe tek

pjesa e mos realizimit te te ardhurave nuk jam naiv sepse kuptohet që është edhe vullnet, dhe vullneti është i lidhur me disa pjesë të objektivave që ka administrata. Ajo që më shqetëson mua në raport është mosrealizimi i shpenzimeve në disa sektorë, ku po marr shembull zjarrfikëset që janë punon jës të administratës bashkiake të cilët në raport me të gjithë punonjësit e administratës së bashkisë rrezikojnë, dhe mos realizimi i shpenzimeve në këtë sektor duke i garantuar atyre kushte më të mira, duke i garantuar atyre pajisje për ndërhyrje etj.etj., ndikon qofte tek pjesa e intervenimit, ashtu dhe tek pjesa e rrezikshmërisë që kanë ata ndaj jetës në raste të caktuara. Prandaj për sektorë të caktuuar do i lutesha administratës, ta kishte parasysh, ta kishte dhe në planin e vet të mëtejshëm dhe buxhetor që disa shpenzime t'i shtynte për më vonë.

Eugen Isaj – antar i këshillit bashkiak- kryetar i grupit te PD.

Nuk është ndonjë problem i madh arritja nga ana e administratës së bashkisë për të ardhurat, ne kemi problem daljen, shpenzimet. Ku shkojnë paratë e taksa paguesve elbasanas. Grupi i këshilltarëve të partisë demokratike sigurisht do i drejtobet administratës dhe ju Z. Kryetar me një kërkesë që zë vendin kryesor në thithjen e parave nga bashkia për inceneratorin. Ka kaluar në heshtje por inceneratori në elbasan vazhdon të marrë një përqitje shumë të madhe parash nga qy tetarët elbasanas, që sic e dimë të gjithë atje as nuk punohet por në momente të caktuara i vihet dhe zjarri për të ulur sa më shumë mbeturinat që janë atje. Pra kjo, në gjykimin tim dhe të këshilltarëve të partisë demokratike është shumë e rëndësishme. Sa para kanë dalë nga bashkia elbasanit për inceneratorin gjatë vitit 2023? Sa planifikohet për vitin 2024? Këto janë cështje që duhen parë me shumë seriozitet. Nuk e di sa përqind e bashkisë, të buxhëtit, kanë kaluar gjatë këtij viti për inceneratorin? Dhe ne duam transparencë pikërisht për këtë gjë. Të ardhurat dhe shpenzimet, ka përgjegjësi kryesore në mos realizim. Këtu tek ne kur jemi vite zgjedhore nuk i shkohet biznesit në muajin prill, maj, qershor, por në muajt shtator, tetor sigurisht duke paguar për gjithë vitin, që është akt shumë i rëndë për biznesin. Unë besoj do presim dhe 3/mujorin e fundit dhe të bëjmë një analizë të saktë si për të ardhurat dhe shpenzimet, por kryesorja për ne në mbledhjet e ardhshme është paketa fiskale. Paketa fiskale me gjithë zërat e saj do shihet nga ne që ne të japim gjithë mendimet tona dhe të japim sado pak ndihmë për të shfryrë tatiimet dhe tarifat e bizneseve. Janë shumë të larta dhe unë besoj se do gjej mirëkuptimin nga ana juaj për t'i ulur aq sa na lejon ligji në maksimum. Unë do ju dorëzoj kërkesën për atë që është gllabëruesi më i madh i parave në buxhetin e bashkisë, që është inceneratori i elbasanit. Faleminderit.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Në lidhje me projekt-buxhetin. Në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat, vërej nga raporti juaj që kemi gati një dyfishim në nivelin e të ardhurave nga ana e bashkisë elbasan, dhe nga kjo arrij të deduktoj duke parë dhe realizimin që është më pak se 50%, nga kjo arrij te deduktoj që keni rritur shpenzimet në ngarkim të qytetarëve që kanë lidhje me tarifat. Megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme për të realizuar të gjithë planin e shpenzimeve e për të mbështetur të gjithë ato shpenzime pa ndohmën e grantit nga ana e qeverisë dhe patjetër të huamarrjes. Në lidhje me këtë do doja informacion të detajuar mbi huamarrjen dhe gjendjen e borxhit të jashtëm të bashkisë elbasan, sepse granti është goxha i konsiderueshëm, ka patur dhe një ritje granti nga 2022 ne 2023, dhe prap kjo nuk e anashkalon pjesën e borxhit të jashtëm. Do doja informacion për këtë borxh, principalin, interesat dhe gjendjen në të cilin ndodhet sot në lidhje me pagesat për këstët mujorë apo gjashtë mujorë, si i keni vendosur nuk e kam idenë. Shikoj ndër të tjera që janë rritur dhe vazhdojnë të planifikohen në rritje shpenzimet për inceneratorin. Sic e preku dhe këshilltari më parë kjo është skandaloze. Një aferë e cila vazhdon të trumbetohet sot në media si korruptive, një incenerator që nuk funksionon, keni dyfishuar shpenzimet per menaxhimin e mbetjeve me anë të tarifave dhe sot vazhdon të planifikojë pagesa të reja. Kjo duhet të ndalojë. Vazhdojmë të planifikojmë pagesa të pandryshueshme në lidhje me strehimin social, në lidhje me ndihmën sociale kundrejt individëve. Unë mendoj që bashkiak elbasan të gjithë grantin që ka në dispozicion, bashkë me huamarrjen që përbëjnë të ardhura të konsiderueshme në arkën e bashkisë, duhet t'i dedikojë një pjesë të rëndësishme të këtyre të ardhurave këtyrë familjeve dhe strehimit social. Nuk përbëjnë këto 0.05% të shpenzimeve të bashkisë ndërkokë që na trumbetohen shpenzime të tjera si inceneratori, ndricimi i rrugëve, e të mos flasim pastaj për asfaltimet e kanalizimet që i keni katërfishuar gjatë vitit elektoral. Kjo është normale se rrini në qetësi për 4 vite e fundit merrni startin me 100 dhe përfundoni me 200/ orë, por unë mendoj që strehimi social duhet të ketë një peshë më të madhe për strehimin social në planifikimin e buxhetit. Kjo ishte e para. Dhe e dyta – duhet të shikohet nëse janë eficente të gjitha këto shpenzime shërbimesh që nëni ju, dhe sidomos nga ana e ASHP-së, kur ne shikojmë rritje të një pas njëshme të shpenzimeve, vit pas viti në shërbim të qytetarëve dhe sot jemi përballë një varreze publike që i ngjan një varreze mesjetare. Sot varrezat publike të cilat kanë edhe këto mirëmbajtje të varrezave publikë që kanë një peshë në buxhetin e bashkisë, janë në një gjendje të mjerueshme. Bari ka mbuluar varret, plerat kanë mbuluar varrezat, mos flas pastaj dhe për prezencën e kafshëve, qenve që flenë kudo në vende që të paktën njerëzit duhet të prehen të qetë. A ka ndonjë kontroll, a ka ndonjë monitorim për këto. A e meritojnë këto këtë buxhetin që ju jepet si drejtori? Sepse edhe në mbledhjen e kaluar, me shumë dëshirë miratuam rritjen e pagave për administratën. A e meriton kjo administrata juaj këtë rritjen e pagës? Cfarë po bën kjo administratë.

Është një rritje e konsiderueshme na raport me të ardhurat, ndërkokë që eficencia po ta llogarisësh në raport me të ardhurat, ndërkokë që eficencia po ta llogarisësh me indikator performance, që nuk e di nëse i keni, eficencia është afër zeros.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Meqë kërkesa për informacion në fakt ishte për herën tjetër, unë mendova që të mos shprehem në raport as me shpenzimet për depozitimin e përpunimin e mbetjeve urbane dhe jo për menaxhimin e inceneratorit. Ju lutem unë e kuptoj që ju jeni pikëpamje politike nga të dyja krahët apo nga të gjithë grupimet, po kur është për të folur për cështje administrative, le të flasim ligjërisht me termat përkatës. Kështu që shpenzimet në raport me procesin e depozitimit, transferimit dhe përpunimit deri në diegie të mbetjeve urbane, nuk kanë pasur asnë rritje. Bashkia Elbasan, ashtu si kundër të gjithë bashkitë e tjera të qarkut, kanë një kontratë me Eco Elb-in e cila është Sh.A. me 100 % kapital shtetëror nga të gjitha bashkitë e qarkut, dhe depozitojnë në bazë të tarifës 25 000 lekë/ton. Kjo është dicka që nuk ka ndryshuar prej dy vitesh e lidhur kjo kontratë që kur është marrë me qera nga Agjensia e sekuestros nga Eco-Elb-i. Kështu që duhet të jemi shumë të qartë që asnë tarifë dhe para e marrë nga taksapaguesit e qytetarët e Elbasanit nuk shpërdorohet por shkon tërësisht në shërbime për ta. Nuk e di se i'do të ndodhët nëse gjithë këto mbetje për të cilat ne referohemi dhe planifikojmë shpenzimet, do të ngeleshin në mes të qytetit, të fushave dhe në menaxhimet sic kanë qenë në kohë të vjetra ku si duket asnijërit nuk i kanë bërë përshtypje në atë kohë. Por sot padyshim vërejtje ka gjithkund për të përmirësuar, dhe ne e kemi diskutuar edhe në komisione, që jemi shumë të hapur për të gjitha vërejtjet, për të gjitha sugjerimet për përmirësimin e shërbimeve, por ama nuk mund të mungojë ajo që duket me sy të lirë, që sot qyteti i Elbasanit është një qytet i menaxhuar mirë në pëstrim dhe shërbime urbane. Të njëjtën gjë do të thosha edhe për pjesën e varrezave, nuk e di nëse i referohemi të njëjtët ambient por gjithsesi unë mendoj që nuk është në këto nivele që paraqitet, madje ka një kurim të vazhdueshëm me heqje inertesh, mbetjesh e kështu me rradhë. Ndërkokë që në raport dhe me kreditinë, nuk e di që nëse e doni informacionin me shkrim apo drejtoresha është këtu dhe mund t'ju shpjegoj një për një të gjitha të dhënët që këruat.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Ne e duam informacionin me shkrim.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Ok. Jua dërgojmë më shkrim si ta doni. Desha t'ju them dhe një gjë tjetër sic e konstatova për treguesit financiar duhet të jeni shumë të qartë sepse kjo gjëja shikohet nga qytetarët dhe ngatërrimi i termave i con në konfortim ata. Treguesit

financiarë, kredia është një gjë komplet tjetër, grantet që vinë se këto janë terma shumë teknike. Grantët që vinë janë grante të kushtëzuara dhe të pa kushtëzuara të cilat shkojnë në destinacionet përkatëse dhe nuk kanë raporte fare. Një gjë tjetër që doja të përmendja që e dëgjova, është që Bashkia Elbasan është nga bashkitë që ka tarifat më të ulta në të gjithë Shqipërinë dhe që prej vitesh mund të ketë bërë një lëvizje shumë të ulët vetëm për tarifën e pastrimit e të ndricimit që sot vazhdon e subvencionon në një masë të madhe. Kështu që nuk e shikoj nga i kanë gjetur këshilltarët treguesit për rritjen e këtyre tarifave. Edhe në raport me taksat, të gjithë mundësitë që ligji i ka dhënë për uljen e taksës së ndërtësës që e paguajnë të gjithë dhe që është pjesa e taksës që ndoshta qytetarët e paguajnë më shumë, dhe Bashkia ka bërë ulje 30%. Bashkia në tarifa dhe në taksa përjashton të gjithë individët që i përkasin një kategorie të caktuar si invalidë, pensionistë të vetëm, pra është një bashki tërësisht sociale, dhe nuk i kanë munguar dhe vjen gjithnjë e më shumë në rritje fondet, qoftë për politikat dhe për përjashtimin nga tarifat dhe taksat të këtyre kategorive, qoftë me trajtimin me programet sociale si bonusi i qerasë, dhe këtu më lini t'ju jap një informacion që përvec që është bërë publik ju mund të njoftoni të gjithë personat që përfaqësoni nëpër njësi dhe qytet që bashkia ka hapur fazën e aplikimit për bonusin e qerasë dhe për të gjithë ata që mendojnë që përbushin kriteret duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Atëherë cështja e inceneratorit nuk ka të bëjë më fare me politikën sepse në fund të ditës këto janë taksa që dalin nga xhepi i gjithsecilit nga ne, kështu që kjo nuk ka lidhje me të majtë, të djathë apo të qendrës. Që s'ka rritje nuk është e vërtetë sepse ka pasur një parashikim dhe realizim 154 032 lekë meqë donit shifra, flasim mijra lekë për 2022, dhe kemi një parashikim të 2023 deri në fund të vitit pritshëm, 239 866, flasim në mijra lekë, kështu që mos thoni që s'ka rritje. Fakti ekzistencës së kontratave, meqë këto kontrata janë abuzive dhe dihet pse janë abuzive, dhe janë dhe pjesë e hetimeve nga ana e organeve kompetente, nuk do të thotë që këto kontrata duhet të vazhdojnë.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Nuk po flasim për të njëjtën gjë.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Është menaxhim i i mbetjeve.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Kontrata që kemi ne është për tjetër gjë, po qe juva vëmë në dispozicion.Pra ju i referoheni një procesi që është krejt i ndryshëm nga koOntrata e menaxhimit që bën bashkia elbasan.Janë dy cështje komplet të ndryshme.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Atëherë na i vini në dispozicion se si i manaxhoni mbetjet, sepse gjendja e mbetjeve edhe nëpër lagje është skandaloze. Herën tjetër do ju vimë me fotografi që të bindeni dhe ju sepse duket që nuk dilni nëpër lagje. Sa për varrezat publike nuk e di sa kohë keni pa shkelur atje, më bëhet qefi që nuk keni shkelur se nuk është ndonjë vend shumë i bukur, por në momentin që shkon, të thellohet akoma më tepër trishtimi.Ju sugjeroj të bëni një vizitë e ta shikoni me sytë tuaj se si është gjendja, meqë u fol për qytetarët.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit të BF.

Unë doja të ndalesha tek pjesa eraaportit të monitorimit të buxhetit për vitin 2023 në pikën A, ku flitet për realizimin e shpenzimeve, me burim financimi transfertën e pa kushtëzuar dhe të ardhurat e vetë vendore..Faktikisht në këtë lloj pasqyre është shembulli më i mirë i performancës së Bashkisë.E them këtë për arsyen se do të shikoni disporpcionin e madh midis shpenzimeve dhe investimeve.Investimet janë në masën 16 %.Në qoftë se flitet për një qytet virtual nga ana Bashkisë, për një qytet i cili plotëson standartet e një qyteti të përparuar, sigurisht që nuk jemi. 16 % realizimi nga plani. Nuk ka indikator më të keq sësa investimet, harxhohen lekë për rroga punonjësit,harxhohen lekë për shpenzizmet operative në vlera pa fund, në vlera ku mund t'i shikoni dhe në fund fare kush është performanca e kësaj bashkie? – Investimet 16%.Ndërkohë që planifikimi apo ligji për qeverisjen vendore, lejon që të paktën nga transferata kushtëzuar mund të shfrytëzohet vetëm 40% e pagës.Pra pjesa tjetër e 60 % do të ishin në kuadër të shërbimeve apo të investimeve.Dhe pikërisht ky raport është krejt ndryshe nga ajo që parashikon ligji për kushtetutën. Mjafton investimi, mos hymë në zëra të përgjithshëm se do kemi kohë për analizën kur të miratohet buxheti, por një zë dhe indikator tregues se ku është Bashkia Elbasanit sot, 16 % investim është skandaloze.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Ky buxhet, ky program, me cfarë miratohet me shumicën e cilësuar apo me shumicë të theshtë, dua dhe mendimin e juristit.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Është monitorim dhe miratohet me shumicë të thjeshtë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Se keni kaluar materiale që donin shumicë të cilësuar. Edhe në proces verbalin e kaluar kishit shënuar 27 vota, kur në fakt me zë dhe me figurë ishin 25 vota. Ju lutem shumë mos manipuloni numrin e votave.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Nuk kisha numëruar vetën time dhe këtë që kam në krah.

Atëherë edhe një hërë kush është pro?

Këshilli bashkiak me **25 vota pro**, 5 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

Votuan kundër – Doris Madhi, Rudina Mita, Valbona Balliu, Ergys Muzhaqi. Armonela Marku.

Abstenuan - Dritan Cepa.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 8-të e rendit të ditës Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 i rishikuar.

Shefget Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Programi është hartuar nga administrata e bashkisë mbi bazën e udhëzimit të Ministrisë së Financave duke pasur parasysh rritja e tavaneve përkatëse në programet ehartuara është një program i detajuar i cili duhet të mbahet në konsideratë për hartimin e një plani vjetor të v. 2024, i cili duhet të reflektojë në mënyrë më të qartë tërë zërat analistikë që janë prioritetë për bashkinë qoftë për investime ashtu dhe për shërbime publike.Besoj që është një program që për vitet 2024-2026 në tërësi komisioni ishte dakord, ju fton ta miratojmë. Unë kisha një parantesë, bashkia elbasan taksën e pastrimit sot e ka 1600 leke, kur e kemi sa 1/3 e Bashkisë Tiranës, e kemi 50% të Bashkisë Korçë, Durrës, Shkodër, dhe simotrat tonë në Elbasan, Cërrik, peqini pothuajse i kanë shumë më të madhe nga ne, dhe unë personalisht jam për rritjen e kësaj takse për të përmirësuar cilesinë e shërbimit. Është një taksë që nuk rëndon qytetarët, por besoj që nuk i mbulon dhe shpenzimet e këtij shërbimi i cili nga dita në ditë kërkon cilësi, është rritur karburanti, janë rritur pagat. Bashkia vazhdon të favorizojë qytetarët me këtë taksë kaq të ulët.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak **me shumicë votash pro**, kundër nuk ka, 4 abstenime miratohet sa më sipër.

Abstenuan – Ergys Muzhaqi, Rudina Mita, Andi Shtylla, Artan Kana.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 9-të e rendit të ditës- Miratim fondi për transportin e sekretarëve në shkollat e arsimit parauniversitar.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Atëherë në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për një gabim teknik nuk janë përfshirë tek transporti rrugor sekretaret e sistemit shkollave parauniversitar, dhe kemi 6 persona që e përfitojnë këtë dhe për t'i barazuar edhe këta me mësuesët, bashkia mendon që nga të ardhurat e saj të financojë 3/mujorin e III-të tetor-dhjetor në shifra që nuk rëndojnë shumë buxhetin, ku 6 punonjës shkojnë në shumën 34 800 për të marrë dhe ata një shpërblim simbolik për transportin e tyre në qendrat e banimit.

Altin Mecja – antar i këshillit bashkiak

90 % e shkollave nuk kanë pastruse, i paguajnë me lekët që i mbledhin nga nxënësit.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Nuk është e vërtetë kjo që po thoni.Herën tjetër do vërtetojmë se kush ka të drejtë, me fakte, me emërimë.Pra konstatimi juaj do verifikohet herën tjetër me një raport të saktë.


Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kundër, abstenim nuk ka, miratohet sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi




Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elyi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjesë N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 1-rë tek të ndryshmet e rendit të ditës- Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.28, datë 26.02.2020 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullososr publik për ndërtimin e HEC it BUKANIKU, në përruin e qershisë".

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Ne si komision e diskutuam këtë problem. Bashkia ka interes për zhvillimin në zonë. Dhe nuk mund ti ndalojë vazhdimisht bizneset për paradokse të vogla. Aty ishin disa probleme të vogla teknike të cilat duhet t'i zgjidhi drejtoria e Sherbimit Pyjor dhe me kadastrën përkatëse për të saktësuar disa gjëra të vogla. Ne në përgjithësi ishim dakord.

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak.

Përshtendetje. Lidhur me dhënien në përdorim dhe heqin në parim të fondit pyjor kullososr publik të sipërfaqeve që preken nga infrastruktura për ndërtimin e HEC-Bukanikut, sic e dinë gjysma nga ju, unë kam qënë kundër sepse aty ka dy vendime këshilli që nuk janë shfuqizuar.Kemi vendim që keni marrë ju si Komunë Shushicë "Për ndërtim ujësjellësi", ka vendim të Komunës Gjinar, Ka pagesë...ka kthyer një përgjigje ku gjashtë fshatra kanë bërë një ankesë për vendimin që është miratuar me këshill. Pra gjashtë kryetarë fshatrash kërkuan mosmiratimin.Nga ana e Bashkisë kthehet një përgjigje që thotë nuk e dimë që ka projekt, kur ka fatura të paguara nga ana e bashkisë. Ka miratime nga Prefekti për vendimet e marra nga këshilli bashkiak, ka projekt ujësjellësi, ka studim gjeologjik, dhe kjo shtesa që vjen tani 400 m tubacion tepër do jetë në atë nivel? Sepse herën e parë u tha do jetë 700 m, tani tel 900, mbas 5 muajve del 1100 m. Kështu që unë kërkoj mosmiratimin për këtë material.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Keni drejtorin këtu dhe e sqaron ai.

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak.

Drejtori mund të jetë por nuk është futur fare në rend të ditës dhe kam dokumentacion që e verteton.Dhe furnizimi me ujë të pishëm furnizon 3 Njësi Administrative që ta dëgjojnë dhe kolegët. Nj.Administrative Shushicë që janë 3 fshatra, Nj.Administrative trega që ikën deri në Qendrën Kurative dhe Nj.Administrative Gjinari, Lleshajt e kanë në Pobrat.Dhe këtu nuk kemi shfuqizuar që herën e parë vendimet e këshillave të komunës dhe janë akoma në fuqi. Faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Me cfarë po shikoj Sokol, ajo në 2020 është bërë fakt i kryer.

Shpëtim Cullhaj – Drejtor i drejtorisë pyjeve.

Përshëndetje. Unë doja të sqaroja se ky është një saktësim sipërfaqe dhe gjatësie të vendimit të këshillit bashkiak Nr 28 date 26.02.2020.Duke qënë se dhe matjet janë bërë tani në mënyrë të dixhitalizuar, kjo është linja, gjatësia është vetëm për saktësim, pra linja është po ajo, shtrirja në hartë është ajo që ka qënë më përpara. Nëse flasim për ndryshime, rrugë shtohen vetëm 129 m.Linjë shtohet vetëm 17 m, tubacion shtohet vetëm 355 m, dhe heqia nga fondi pyjor shtohet vetëm 340 m që janë shtuar vetëm bazamentë dhe shtylla dhe që e ka dhe kuadri ligjor që duhet të hiqen nga fondi pyjor.Domethënë janë ndryshime të vogla, janë saktësime të VKB Nr 28 dt.26.02.2020.Faleminderit.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Ajo që po i referohej Sokoli, që në fakt të gjithë duhet të kenë dijeni, është që kur vendimi i parë ka kaluar në vitin 2020, vërtet ka pasur një debat, po të njëjtin që Sokoli po referon por gabimi është që nuk jemi në të njëjtat fazë proceduriale, dhe mendoj që në atë kohë për aq sa unë kam kujtesën, Sokol janë saktësuar, janë verifikuar me grupe ekspertësh të dy projektet. Edhe projektii ujësjellësit për të cilin ti ke një interes të vecantë, edhe projektii tjetër në të cilën shtrihet, dhe është parë që të dyja projektet janë të mundshme dhe teknikisht janë të realizueshme dhe nuk e kuptoj pse duhet sjellë në një fazë të dytë që ka të bëjë vetëm me saktësime. I njëjti diskutim në fazën paraprake kur të gjitha ato që ju po thoni nuk janë të vërteta. Bashkia nuk ka hezituar në asnjë rast të kthejë një përgjigje në raport me këtë. Kjo vendimmarrje ka qënë e këshillit, ka qënë publike, madje për më shumë

është bërë dhe konsultim me specialistë, me teknikë, dhe këshilli ka qënë prezent në prezantimin e të dy projekteve paralel. Kjo ishte sa për saktësim.

Eva bica – antare e këshillit bashkiak.

Miratimi merret nga këshilli basenave.

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Çfarë është këshilli basenave.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ky material kërkon 3/5 e votave të këshillit.

E hedh në votim materialin.

Votuan pro 26 këshilltarë 4, kundër, 3abstenime - nuk miratohet pasi nuk ka votat e mjaftueshme.

Votuan kundër – Sokol Sinani, Arbi Fetah, Doris Madhi, Artan Kana.

Abstenuan – Eugen Isaj, Naim Meta, Ergys Muzhaqi.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 2-të tek të ndryshmet e rendit të ditës- Transferim fonde në buxhetin e vitit 2023, për aktivitete.

Shefzet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Bashkia Elbasan bën pjesë në projektin “100 qytete neutralë e të zgjuara” që është deri në vitin 2030. Komiteti europian më 24 tetor do të bëjë njëëorkshop bashkë me me qytetet e Ballkanit perëndimor e vendet e BE-së. Është një takim serioz të cilil ne duhet t'i japim seriozitetin e duhur, për të nderuar edhe miqtë por edhe bashkinë, dhe kërkohet një fond prej 1 900 000 që do të jenë shpenzime për vajtje ardhje në Rinas, akomodim, një darkë që do të bëhet për nder të pjesëmarrësve në këtë takim të rëndësishëm, dhe është parashikuar nga bashkia që te pakësojë zërin aktivitete ne disa zëra të tjerë dhe të shtojë këtë zë për të përbushur detyrim et sa më mirë të këtij aktiviteti më 24 tetor 2023, dhe ftoj këshilltarët ta miratojnë, për vetë rëndësinë që ka ky aktivitet.Promovimi që di i bëhet Elbasanit në këtë lloj paneli ia vlen.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me 31 vota pro, kundër, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë te ndryshëm si dhe media.

Pika 3-të tek të ndryshmet e rendit të ditës- Për një ndryshim të VKB-së nr.80 datë 13.09.2023 “Lidhja nr.8” Mbi nivelin e pagave të Qendrës së Artit”.

Shefzet Bullari – kryetar i komisionit të financave,buxhetit dhe aseteve publike.

Në vendimin e mëparshëm është bërë një gabim teknik nga administrata, i cili u pa në detaje dhe nga organi i Prefektit, dhe është sugjeruar të bëhen dy tre ndryshime pagash, në dy tre pozicione në Qendrën e Artit, për t'i rakorduar më mirë me VKM-të përkatëse.

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Për të qënë më të saktë, lidhja 8 në pikën 4, ku ka një grupim specialistësh, shtesa për pozicion ishte vendosur 52 000 lekë, ndërkohë ka qënë 40 000, dhe shtesa ishte 60 mijë lekë pra duhej të shkonte 46 000 lekë. Dhe korigjimi tjetër është që të jemi sa më transparentë dhe të qartë, udhëheqësi artistik i cili bën formatin e përgjegjësit për të gjithë shfaqet duhej të ngruhej në një nivel me përgjegjësin e financës, por ishte harruar dhe ishte vendur tek specialistet.Këto janë dy korrektimet e gabimeve që ishin tek vendimi i parë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Me shumicë votash pro, kundër, abstenim nuk ka, miratohet sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.10.2023 , ora 11:05 në ambjentet e Qendrës Rinore "Riemar" Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur.Gjithashtu marrin pjese N/Kryetare e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Drejtorë Drejtorie, e specialistë te ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika 4-tërt tek të ndryshmet e rendit të ditës – Miratimi i kalendarit të konsultimeve me publikun.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Grafiku i konsultimeve është gati sic e shihni, por sekretariati ta marrë dhe për 2-3 ditë t'i vendosë datat e orët e konsultimeve.A jeni dakord?

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Unë kam një vërejtje. Për aq kohë sa zhvillohen konsultimet, duhet të na jepet një informacion se cfarë ka ndodhur në konsultim pasi asnjë këshilltar nuk di gjë. P.sh. unë nuk e di se cfarë ka ndodhur në konsultimin e zhvilluar ne Labinot.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Patjetër që po, sa herë të ketë diskutime të tillë do viheni në dijeni dhe do ju vëmë materilet në dispozicion.

Dritan Cepa – antar i këshillit bashkiak.

Sugjeroj që për konsultimet, stafi i këshillit bashkiak t'ia cojë me e-mail cdo antari të këshillit bashkiak

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit BF.

Duhet të ketë një lloj informacioni për cdo konsultim, p.sh. para konsultimit publiku duhet të informohet sa është vlera investimit, cfarë projekti ka

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Nuk desha të ndërhuj më parë. Nuk jemi në kushtet kur kjo sipërfaqe jepet mbi bazën e një propozimi të kërkuar. Jemi në kushtet kur kjo sipërfaqe del në konkurim për këtë objektiv, sepse administrata e bashkisë ka vlerësuar se janë sipërfaqe që janë eficente për këtë qëllim. Pas kësaj do kalojë për konkurim, dhe kur të kalojë për konkurim, kalojmë në fazën e prezantimit të projekteve sic i kërkon ligji dhe nëse këshilli do patjetër në atë fazë pa bërë përzgjedhjet, mund të vëmë në dispozicion këtë gjë që kërkoni. Tani që po flasim, ti e di që ligji ka dy parashikime. Një –Për propozimin e parakërkuar mbi bazën e të cilit iniciohet procedura, dhe një që fillon nga administrata dhe që nuk ka një projekt në këtë fazë. Janë parashikimet ligjore, dhe ne këto gjëra i dimë shumë mirë dhe jemi në këtë moment.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit BF.

Jam dakord. Problemi është – Kush do të jetë impakti qoftë edhe për këtë sipërfaqe që ju pretendoni. Cfarë i keni paraqitur ju qytetarit. A ka një proces verbal - . Cfarë i keni paraqitur ju qytetarit?

Aulona Bylykbashi – N/kryetare e Bashkisë.

Ne qytetarëve i kemi paraqitur të gjithë dokumentin, përvecse është pjesë e këshillit. Por me aq sa kam unë dijeni i gjithë dokumentacioni ashtu sic e kanë pasur këshilltarët, raporti teknik që pse kjo sipërfaqe është e mundshme për t'u përdorur për këtë qëllim., hartat përkatëse, të gjithë përllogaritjet tarifore të vlerave ashtu sic e kërkon ligji dhe VKM-të përkatëse, i janë paraqitur të gjitha qytetarëve. Ky dokument ka qënë publik në ëebsid-in e këshillit bashkiak që nga dita që është bërë njoftimi. Për të qënë të saktë, unë nuk doja të ndërhyja në këtë diskutim pasi është i këshillit, por për të qënë të vërtetë, konsultimet janë bërë ashtu sic duhet dhe jo një-dy. Konsultimet janë bërë një në Labinot Fushë dhe një në Labinot Mal. Megjithatë meqënëse Dorisi i ka shkruar sekretarit të këshillit dhe ka kërkuar që të ndiqet dhe një procedurë tjetër, ne e kemi hequr nga rendi i ditës materialin, dhe po bezme publikimet e tjera për të parë. Pjesëmarrja është në dorën e qytetarëve, dhe këshilltarëve. Ne nuk detyrojmë të vijë njeri me zor o Blendi.

Blendi Himci – antar i këshillit bashkiak – kryetar i grupit BF.

Atëherë ka dy momente Aulona. Së pari – Në takimin që është bërë në Labinot Fushë, ka pasur një takim dhe nuk u diskutua asnjë pikë nga këto që po thoni ju këtu.. Ka pasur dhe këshilltarë të pranishëm dhe nuk kishte asnjë nga këto pika që u paraqiten këtu. Ka pasur dhe kontestime dhe të gjithë e kemi filmuar si takim. Tani unë po flas që për të qënë shumë korrekt në këtë lloj konteksti, nuk po e them unë si përfaqqsues i forcës time politike, po e them që të zbatohen procedurat në mënyrën më korakte të mundshme, dhe ligji që ju i referoheni për konsultimin

publik thuhet: duhet të përdorësh cdo lloj mjeti informimi, nuk mund të konsultohem thjesht dhe të lihet në dorën e kryetarëve të Njesisë Administrative për të njofuar ata 5 veta që ju interesojnë ju. Duhet të njoftohet cdo familje dhe cdo qytetar, gjë e cila në zonën përkatëse për të cilën po flasim, nuk ka ndodhur. Unë për këtë jam, po të ndjekim procedurën pse të mos vazhdojmë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Normalisht ate ditë ishte takimi i parë.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Atë ditë as kryetari Njësisë Administrative nuk e dinte që kishte takim.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ne kishim qëllim të mos dëmtoshim, pra të mos merrnim toka të cilat ishin të mbjella me ullinj, dhe të mos krijonim konflikt me fermerët.

Atëherw mbledhjen e deklaroj tw mbyllur.

Mbledhja mbylllet në orën 12.25'.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

EIVI CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA